

Të nderuar gazetarë, përfaqësues të mediave,

Jam shumë i nderuar me prezencën tuaj sot për të shënuar përsëri së bashku përfundimin e një viti të suksesshëm për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe sistemin financiar të Kosovës. BQK-ja më aktivitetet e saj ka vazhduar të siguroj një sistem financiar stabil dhe të mbështes zhvillimin ekonomik të vendit.

Pjesë e suksesit tonë është gjithashtu komunikimi me mediat të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në informimin e publikut për zhvillimet në sistemin ekonomik të vendit. Transparenca me publikun dhe komunikimi me media është i një rëndësie të veçantë dhe gjatë këtij viti kemi avancuar me shumë bashkëpunimin në këtë fushë. Ne konsiderojmë se gjatë këtij viti kemi pasur komunikim efektiv me media duke siguruar informatat dhe sqarimet e nevojshme në çdo kohë.

Tani, më lejoni që para jush të paraqes një përmbledhje të zhvillimeve më të rëndësishme në sistemin financiar dhe ekonominë e vendit gjatë vitit 2019, natyrisht me të dhënat më të fundit që i kemi në dispozicion.

Sipas vlerësimeve preliminare në vitin 2019 rritja ekonomike pritet të jetë rreth 4.2%, rritje kjo e mbështetur kryesisht nga rritja e investimeve dhe përmirësimeve në eksportet neto.

Ritëm i ngjashëm i rritjes ekonomike, sipas parashikimeve të BQK-së, pritet edhe në vitin e ardhshëm.

Norma mesatare e inflacionit vjetor deri në nëntor 2019 është rritur për 2.8%, në krahasim me normën prej 0.9% në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Rritja e

normës së inflacionit gjatë këtij viti kryesisht është rezultat i rritjes së çmimeve të ushqimit.

Sektori bankar edhe në këtë vit vazhdoi me rritje të lartë të kreditimit, përmirësim të kushteve për qasje të sektorit privat në kredi, si dhe rritje të qëndrueshmërisë financiare. Në fund të tetorit 2019, kreditë e sektorit bankar kanë arritur vlerën prej 2.98 miliard euro. Rritja vjetore e kredive mbetet e lartë me normë vjetore prej 10%. Burimi kryesor i financimit të aktivitetit të sektorit bankar vazhdojnë të jenë depozitat, shuma e të cilave gjatë kësaj periudhe arriti në 3.75 miliard euro që paraqet një rritje vjetore mjaftë të lartë prej 16%. Kjo rritje e lartë e depozitave mes tjerash reflekton edhe besimin e lartë të publikut në sektorin bankar.

Normat e interesit në kredi vazhduan trendin rënës, duke zbritur në 6.5% nga 6.6% sa ishin në periudhën e njëjtë të viti të kaluar, gjë që reflekton përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të tregut dhe lehtësimin e qasjes në financim bankar. Treguesit e shëndetit financiar vazhduan të tregojnë nivel të lartë të qëndrueshmërisë së këtij sektori në të gjitha aspektet. Vlen të theksohet posaçërisht cilësia shumë e mirë e portofolit kreditor me një normë të kredive joperformuese prej vetëm 2.1% në tetor 2019, e cila shënoi rënie të mëtutjeshme në krahasim me vitin e kaluar kur ishte 2.7%. Cilësia e portofolit kreditor jo vetëm që është më e larta në rajon, por është më cilësore edhe krahasuar me disa ekonomi të Bashkimit Evropian. Ky fakt, përveç që pasqyron gjendjen e shëndoshë të sektorit bankar të Kosovës, duhet të potencohet pasi që shërben edhe si një tregues shumë i rëndësishëm për kushtet që ofron tregu jonë e që paraqet një element shumë të rëndësishëm për investitorët që mund ta konsiderojnë Kosovën si destinacion për ta investuar kapitalin e tyre.

Me zhvillime të favorshme u karakterizua edhe sektori i fondeve pensionale. Vlera e asetëve të sektorit pensional në shtator 2019 arriti në 1.92 miliard euro, duke shënuar rritje vjetore prej 8.8%. Kthimi nga investimet e fondeve pensionale ishte mjaftë i kënaqshëm (138 milion euro deri në janar në shtator 2019), gjë që tregon për rritje të vlerës së kursimeve pensionale të qytetarëve.

Sektori i sigurimeve vazhdoi të rrisë aktivitetin sigures, si dhe kompensimin e dëmeve për të siguruarit. Gjithsej vlera e shkruar e primeve nga kompanitë e sigurimeve deri në shtator 2019 ishte 74 milion euro, e cila paraqet një rritje vjetore prej 7.1%. Në anën tjetër, vlera e dëmeve të paguara arriti në 37.9 milionë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 7.3%. Raporti ndërmjet dëmeve të paguara dhe primeve të pranuar arriti në 51.2%, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kur ky raport ishte 51.1. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës po angazhohet në vazhdimësi për të siguruar trajtimin korrekt të dëmeve nga kompanitë e sigurimeve.

Me qëllim të sigurimit të stabilitetit financiar dhe si pasojë e mospërputhjes me kërkesat rregullative dhe mosrespektimit të masave përmirësuese të BQK-së, në vitin 2019, në rolin e saj prej rregullatorit dhe mbikëqyrësi të institucioneve financiare, BQK-ja i ka revokuar licencën kompanisë “Insig” SH.A., Dega Kosovë.

Me qëllim të mbrojtjes së palëve të dëmtuara prej të siguruarve nga autopërgjegjësia dhe krijimit të kushteve të nevojshme për zhvillim të qëndrueshëm të sektori të sigurimeve, BQK-ja ka përshtatur tarifën e Kategorisë I për sigurimin e detyrueshëm nga auto-përgjegjësia ndaj palës së tretë të cilat ishin të pandryshuara që nga vitit 2001. Studimi aktuarial nga kompanitë e sigurimit, ka sugjeruar për rritje të tarifave të Kategorisë I (automjete me pasagjerë) për 36.56%. Megjithatë, BQK në

vlerësimin e saj ka identifikuar disa faktorë të cilët nuk janë reflektuar plotësisht në raportin aktuarial, prandaj edhe ka refuzuar kërkesën e kompanive të sigurimit për ndryshim të tarifave duke u bazuar në atë raport, por në të njëjtën kohë ka vlerësuar se kompanive të sigurimit duhet t'u mundësohet përshtatja e tarifave të Kategorisë I për shkallën e inflacionit të ndodhur gjatë periudhës 2002-2018, i korrigjuar për ndryshimet e reflektuara me Ligjin për të Ardhurat e Korporatave, në mënyrë që këto tarifa të sigurimit të reflektojnë sa më mirë kushtet aktuale të ekonomisë. Ky vendim i BQK-së kishte nxitur reagime të ndryshme. Megjithatë në ju bëjmë thirrje që ky vendim i cili ka përshtatur çmimet vetëm për rritjen e inflacionit të mos keqinterpretohet duke i lënë anash përfitimet që do të kenë të siguruarit në të ardhmen dhe impaktin në rritjen e stabilitetit financiar. Kjo përshtatje është gjithashtu e përkohshme pasi që gjatë vitit të ardhshëm BQK planifikon të liberalizoj tregun e sigurimit të detyrueshëm nga auto-përgjegjësia ndaj palës së tretë.

Një sektor tjetër i rëndësishëm i sistemit financiar është sektori i institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve jo-bankare, i cili po vazhdon ta përshpejtojë ritmin e kreditimit. Në këtë mënyrë, ky sektor çdo ditë e më tepër po i kontribuon rritjes së konkurrencës në tregun e kredisë dhe po përmirëson qasjen në financa. Gjithsej vlera e kredive të këtij sektori në tetor 2019 arriti në 217.1 milion euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 22.2%. Gjatë këtij viti, normat e interesit efektiv janë zvogëluar nga 23.1% në 20.3%.

Pak kohë më parë, siç edhe jeni të njoftuar, BQK-ja ka revokuar licencën e dy institucioneve IMF "Iute Credit Kosovo" Sh. A. dhe për IFJB "Monego", të cilat gjatë viteve të operimit në tregun tonë, në vazhdimësi kanë devijuar nga planet e tyre të biznesit në bazë të të cilave kishin marrë licencat për të operuar në Kosovë, duke

i sjellë kështu tregut tonë diçka tjetër prej asaj që kishin premtuar që do të sjellin. Devijimi më i rëndësishëm dhe më shqetësues nga planet e tyre të biznesit, në bazë të të cilave kishin marrë licencën, ka të bëjë me normat e interesit që këto institucione kanë aplikuar në kredi, të cilat kanë rezultuar të jenë shumëfish më të larta në krahasim me normat që këto institucione kishin paraparë në dokumentacionin e aplikimit për licencë, i cili paraqet një element shumë të rëndësishëm në procesin e marrjes së vendimit për aprovimin e licencave për institucionet financiare.

Lidhur me këtë proces, ne po vërejmë forma të ndryshme të presionit publik ndaj këtyre vendimeve, por dëshirojmë të ritheksojmë se BQK ka vepruar në përputhje të plotë me mandatin e saj ligjor dhe jemi të bindur se veprimi jonë është i drejtë, prandaj asnjë formë e presionit publik nuk mund të çojë në rishikimin e këtyre vendimeve. Ne e respektojmë plotësisht të drejtën e palëve për të ndjekur rrugët ligjore për të parashtruar ankesë ndaj këtyre vendimeve dhe kërkojmë nga palët e afektuara nga këto vendime që të ndjekin rrugët ligjore. Ne jemi të gatshëm që në çdo kohë të dëshmojmë dhe të sqarojmë bazën mbi të cilën kemi marrë këto vendime.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës vazhdon të veproj në funksion të mbështetjes së zhvillimit të qëndrueshëm të sistemit financiar, duke siguruar infrastrukturën e nevojshme ligjore për të mbështetur zhvillimin e institucioneve financiare dhe në të njëjtën kohë duke u siguruar stabilitet financiar. Harmonizimi i kornizës rregullatore me zhvillimet e fundit ndërkombëtare në këtë fushë, më konkretisht në Bashkimin Evropian, ka vazhduar të jetë prioritet i rëndësishëm i BQK-së edhe gjatë këtij viti, me ç'rast janë përpiluar rregullore të ndryshme të cilat

avancojnë aspekte të ndryshme të rregullativës bankare e në veçanti atë të qeverisjes korporative të bankave.

BQK-ja edhe këtë vit ka rritur angazhimin e saj edhe në funksion të mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve të shërbimeve financiare, duke i shërbyer kështu në mënyrë të drejtpërdrejtë mbrojtjes së interesit të publikut. Në këtë vit BQK ka avancuar programet e edukimit financiar dhe ka aplikuar masave korrektuese ndaj institucioneve financiare me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve. Kjo fushë do të vazhdoj të ketë prioritetin e lartë edhe në vitin e ardhshëm.

Një shpalosje më të detajuar të zhvillimeve ekonomike e financiare, si dhe të aktiviteteve të BQK-së gjatë vitit 2019 do të mund ta gjeni në Raportin Vjetor të BQK-së i cili do të publikohet në pjesën e parë të vitit të ardhshëm.

Para se të kalojmë te pyetjet e juaja, dëshiroj të ju njoftoj se BQK-ja edhe në vitin 2019 ka shpërndarë çmimin “Ekonomist i Ri” me qëllim të nxitjes së aktivitetit hulumtues në fushën e ekonomisë në mesin e të rinjve. Shfrytëzoj rastin t’i falënderoj dhe përgëzojë të gjithë kandidatët për punimet e tyre që i kanë dorëzuar në kuadër të këtij konkursi.

Bazuar në vlerësimin e komisionit për vlerësimin e këtyre punimeve unë sot kam kënaqësinë që të shpallë dy fitues të këtij çmimi, duke shpresuar se kjo do t’i motivojë autorët e këtyre punimeve dhe të rinjtë e tjerë që të vazhdojnë dhe ta avancojnë edhe më tutje punën e tyre hulumtuese.

Çmimi i parë i jipet z. Jeton Shatri për studimin me titull: “Faktorët që Influencojnë Kënaqësinë e Punonjësve: Një Studim i Sektorit Privat Bankar të Kosovës”, ndërsa

Çmimi i dytë i jepet znjsh. Blina Zhubi për studimin me titull: “Efektet e transaksioneve elektronike me fokus në luftimin e informalitetit: Trendet e realizimit të transaksioneve elektronike në Kosovë”

Në fund, më lejoni t’ju falënderoj për zemërsisht për bashkëpunimin, profesionalizmin dhe korrektësinë që keni treguar gjatë informimit lidhur me zhvillimet financiare dhe ekonomike dhe aktivitetet e BQK-së gjatë këtij viti dhe t’ju uroj shumë shëndet, lumturi e suksese juve dhe familjeve tuaja për vitin 2020.

Tani mirëpres pyetjet tuaja.